



## **SYLLABUS I LËNDËS “MBROJTJA E PYJEVE NGA ZJARRET”**

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Jeta dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Mbrojtja e pyjeve nga zjarret</b>
<b>Programi:</b>	<b>Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i tretë , semestri i dytë</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Do shpallet</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Asoc.Dr. Mirvjena Kellezi</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<b>mirvjena.kortoci@uni-prizren.com</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Kjo lëndë ka për qëllim të prezantojë studentët me çështjet kryesore të zjarreve me të cilat përballen pyjet e planetit tonë. Përgjithësimet mbi zjarret në pyje. Bimësia pyjore e vendeve mesdhetare dhe kushtet klimatike specifike që favorizojnë zjarret në këto teritore. Disa patologji dhe dëme nga insektet mbi bimët pyjore që krijojnë kushte favorizuese për zjarret. Shkaqet e zjarreve me natyrë aksidentale dhe ciklike. Përcaktimi i vatrave të mundshme të zjarreve, ngritja e sistemit të vrojtimit sinjalizimit. Masat për parandalimin e zjarreve: masa silvoteknike, mekanike dhe të veçanta. Masat për kufizimin e një zjarri. Efektet e djegies mbi biocenozën e ekosistemeve pyjore. Efektet e djegies masive të pyjeve në ndotjen e ajrit. Mekanizimi dhe motorizimi i procesit të shuarjes së zjarreve në pyje. Paisjet e sigurisë gjatë lokalizimit dhe shuarjes të zjarreve pyjore. Legjislacioni dhe institucionet përgjegjëse mbi mbrojtjen e pyjeve nga zjarri.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde mbështet njohjen e strukturës pyjore dhe efektet që shkaktojnë disa shkaktarë natyral të zjarreve në pyje, por edhe aksidental nga njeriu. Mbështetet në njohjen e legjislacionit vendor dhe evropian mbi mbrojtjen e pyjeve si dhe shkaktarët e mundshëm që mund të çojnë deri tek zjarret në pyje.</p>
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Të përcaktojnë konceptin e zjarrit në pyll.</li><li>2. Të parashikojë infrastrukturën e nevojshme që ndërtohet me qëllim parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje.</li><li>3. Të klasifikojë dhe të monitorojnë dëmin e shkaktuar nga zjarret në pyje.</li></ol>



	<p>4. Të gjykojë mbi zhvillimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe përdorimin e mekanizmave efikase në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.</p> <p>5. Të kombinojë mënyrat e mësuara për parandalimin konkret të zjarreve.</p>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	1	15	15
Kollokfiume, seminare	2	-	2
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	5	10
Projektet, prezantimet ,etj	3	-	3
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, seminare, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, detyre kursi, provime.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokvium): 10%, Vlerësimi i dytë (kolokvium): 10%, Seminaret ose angazhime të tjera: 10%, Provimi final: 70%, Total: 100%.		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<p>Département Gestion des territoires, Division Agriculture et Forêt Méditerranéennes”International Handbook on Forest Fire Protection Technical guide for the countries of the Mediterranean basin.</p> <p>Miltiadis Athanasiou” Forest fires: management, characteristics and prediction”.</p> <p>Regional Fire Monitoring Center “Forest Fires in South Eastern Europe, Regional Report”.</p>		
<b>Literatura shtesë:</b>	Peter Hirschberger (2016). Causes and effects of global forest fires.		

### Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	Hyrje. Djegia. Menytrat e transferimit te nxehtesise. Çfarë është vetëndezja, dhe çfarë ndezja? Fazat e djegies të drurit dhe produktet e djegies Çfarë është djegia e drurit?	Demonstrim praktik mbi transferimin e nxehtesise. Si te dallojme vetëndezjen dhe ndezjen. Demonstrim praktik mbi fazat e djegies të drurit dhe produktet e djegies.
<i>Java e dytë:</i>	Produktet e djegies se drurit. Shkaqet per paraqitjen e zjarreve. Zjarret ne Kosove. Institucionet pergjegjese dhe kuadri ligjor.	Paraqitja e statistikave te ndryshme (nga ana e pedagogut dhe studenteve) mbi zjarret ne Kosove dhe shkaqet e renies se tyre si ne Kosove ashtu edhe ne pergjithesi. Njohja konkretisht me institucionet pergjegjese te Kosoves dhe kuadrin ligjor. Praktike mbi klasifikimin e zjarreve pyjore.
<i>Java e tretë:</i>	Shkaqet per paraqitjen e zjarreve. Zjarret ne Kosove. Institucionet pergjegjese dhe kuadri ligjor. Klasifikimi i zjarreve pyjore.	Studimi i ndikimit te llojit te bimesise, topografise, stineve dhe klimes ne shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ( drejtim, shpejtësi dhe intensitet). Detyre kontrolli mbi mbi klasifikimin e zjarreve pyjore.
<i>Java e katërt:</i>	Klasifikimi i zjarreve pyjore. Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ( drejtim, shpejtësi dhe intensitet).	Studimi i paraqitjes i faktorëve të ndryshëm si përbërja llojore e grumbulli, dendësia apo shpërndarja e materialit djegës që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve.
<i>Java e pestë:</i>	Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ( drejtim, shpejtësi dhe intensitet).	Demonstrime praktike nga aktorët kryesor në Kosovë (shërbimi pyjor) të përfshirë në luftën ndaj zjarreve pyjore mbi masat për parandalimin e këtyre zjarreve.
<i>Java e gjashtë:</i>	Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen dhe zhvillimin e zjarreve ( drejtim, shpejtësi dhe intensitet). Masat për parandalimin e zjarreve pyjore.	Demonstrime praktike nga aktorët kryesor në Kosovë (komuna) të përfshirë në luftën ndaj zjarreve pyjore mbi masat për parandalimin e këtyre zjarreve (masat parandaluese, pergatitore dhe direkte).
<i>Java e shtatë:</i>	Masat për parandalimin e zjarreve pyjore.	Konkretizimi nepermjet me mjete video dhe ne terren i masave direkte ( me toke, me uje, me kimikate, eksploziv etj.) për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve pyjore.
<i>Java e tetë:</i>	Masat për parandalimin e zjarreve pyjore.	Konkretizimi nepermjet mjeteve video dhe ne terren i mjeteve per shuarjen e zjarreve pyjore. Taktika



		me dy kembe, pengesat kundra zjarrit, kundrazjarri, aviobombardimi etj.
<i>Java e nëntë:</i>	Taktikat për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve pyjore.	Shembuj dhe konkretizime mbi zhvendosjen individuale, ne grupe dhe progresive e zjarrfikësve përgjatë vijës së pozicionit mbrojtës.
<i>Java e dhjetë:</i>	Taktikat për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve pyjore.	Demonstrime video dhe ne terren mbi zhvendosjen individuale, ne grupe dhe progresive e zjarrfikësve përgjatë vijës së pozicionit mbrojtës.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Zhvendosja e zjarrfikësve përgjatë vijës së pozicionit mbrojtës.	Formimi, organizimi si dhe aktoret pjesmarres në shtabin që udhëheq aksionin për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Zhvendosja e zjarrfikësve përgjatë vijës së pozicionit mbrojtës.	Veshjet dhe pajisje të përshtatshme për të shmangur aksidentet e zjarrfikësve në lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve pyjore.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Organizimi i lokalizimit dhe shuarjes të zjarreve pyjore të shkallës më të gjerë.	Detyre kontrolli mbi taktikat për lokalizimin dhe shuarjen e zjarreve pyjore. Zhvendosja e zjarrfikësve përgjatë vijës së pozicionit mbrojtës. Parimet dhe paisjet e sigurisë gjatë lokalizimit dhe shuarjes të zjarreve pyjore. Detyre kursi-Evidentimi i nje siperfaqeje pyjore te djegur. Analizimi i shkaqeve dhe masave te marra ne ate rast.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Organizimi i lokalizimit dhe shuarjes të zjarreve pyjore të shkallës më të gjerë.	Detyre kursi-Evidentimi i nje siperfaqeje pyjore te djegur. Analizimi i shkaqeve dhe masave te marra ne ate rast.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Parimet dhe paisjet e sigurisë gjatë lokalizimit dhe shuarjes të zjarreve pyjore.	Detyre kursi-Evidentimi i nje siperfaqeje pyjore te djegur. Analizimi i shkaqeve dhe masave te marra ne ate rast.
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
<p>Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjesë në vizita studimore në terren (ekskursion). Shkycja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.</p>		